

INSTITUTI GJYQËSOR I KOSOVËS

BULETINI

Përmbajtja

Aktivitetet e muajit nëntor - dhjetor **1-18**

Kalendari **19**

Pikat kryesore

- Trajnimet nga lëmia penale
- Trajnime nga e lëmia civile
- Trajnimet mbi Konventën Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut
- Trajnimet për Kodin e Etikës
- Trajnime për të mitur
- Trajnime mbi Antitrafikimin

Mbrojtja e Pronësisë

Më datën 01 nëntor 2007 u mbajt tryeza e diskutimeve nga lëmia civile me temë "Mbrojtja e Pronësisë". Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmis civile të të gjitha regjioneve të Kosovës.

Temat të cilat u shtjelluan gjatë punës së kësaj tryeze u përqendruan në çështjet që kanë të bëjnë me mbrojtjen e pronësisë respektivisht paditë për mbrojtjen e pronësisë sipas legjislacionit pozitiv në Kosovë si dhe u diskutua për praktikën gjyqësore në këtë lëmi. Nga diskutimet e shumta, nga tryeza mund të veçohen këto përfundime:

- E drejta e pronësisë është një ndër institutet më të rëndësishme i së drejtës sendore. E drejta e pronësisë është e rregulluar me ligje nacionale dhe me norma ndërkombëtare (Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Liritë Themelore, Protokollin I, si e drejtë themelore e njeriut).
- E drejta e pronësisë përveç në të drejtën civile, mbrohet edhe në degët tjera të së drejtës si, në të drejtën penale, administrative, kushtetuese etj.

Paditë në përgjithësi ndahen në: padi proceduralo juridike dhe ato materialo-juridike. Me paditë proceduralo juridike realizohet mbrojtja juridike e përmbajtjes së caktuar të drejtës subjektive e cila në fakt paraqet petitumin e kërkesëpadisë, ndërsa paditë materialo juridike i përshtaten degëve të caktuara të lëmis civile si; të drejtës familjare, të drejtës së punës etj, mirëpo edhe në kuadër të degëve të caktuara dallohen padi të veçanta varësisht nga institutet përkatëse juridike si; paditë pronësore, paditë posesore.

- Nga formulimi ligjor konstatohet se për mbrojtjen e të drejtës së pronësisë sipas padisë së reivindikimit duhet

dhembjeve e shkallëzojnë si të intensitetit të lartë, të mesëm dhe të ulët, por shpërblimi duhet të caktohet unik e jo për çdo shkallë të intensitetit të dhimbjeve.

Forma e shpërblimit të dëmit për shkak të shëmtimit është paraparë me dispozitën e nenit 200 par. 1 të LMD, sipas të cilës lartësia caktohet varësisht prej të gjitha rrethanave të rastit në të cilat kohëzgjatja dhe intensiteti i frikës janë rrethana të veçanta. Kjo dispozitë e zgjeron

mundësin e caktimit të shpërblimit të dëmit në raport me qëndrimin e praktikës së gjykatave i cili ka qenë se shpërblimi i formës së tillë të dëmtuarit i takon vetën nëse frika ka qenë e intensitetit të vazhdueshëm dhe ka lënë pasoja të vazhdueshme. Me rastin e caktimit të kësaj formë të dëmit duhet të merret parasysh edhe dëmtimi i ekuilibrit psikik të dëmtuarit.

Kodi i Etikës

Me datën 13 dhjetor 2007, IGJK-ja organizoi trajnimin lidhur me Kodin e Etikës, dedikuar gjyqtarëve dhe prokurorëve të të gjitha niveleve për regjionin e Gjilanit.

Interpretimi i dispozitave që përmban ky kod dhe respektimi i tyre bënë që të kemi një gjyqësor të drejtë, objektiv dhe të paanshëm, ndërsa të gjitha ato sjellje që vijnë në kundërshtim me këto rregulla, rezultojnë me dukuri negative dhe më pas vije deri te humbja e besimit të qytetarëve që është gjëja më e keqe që mund të përjetoj gjyqësori dhe shoqëria. Andaj, u kërkua që gjyqtarët dhe prokurorët të jenë më të vëmendshëm në punën e tyre.

Edhe në këtë sesion trajnues u shfaqën mjaft brenga nga ana e gjyqtarëve dhe prokurorëve për shkak të vëllimit

shumë të madh të lëndëve që është një nga shkaqet kryesore që ata nuk mund të jenë azhur në shqyrtimin e lëndëve, e cila paraqet një rën nga shkeljet e Kodit të Etikës. Po ashtu sa i përket menaxhimit të lëndëve deri në përfundim të rastit, gjithsesi rol aktiv duhet të ketë si gjyqtari ashtu edhe prokurori, por edhe stafi përcjellës duhet të dijë çdo shkresë që dorëzohet në gjykatë apo prokurori dhe koordinimi më i mirë i këtyre veprimeve jep një sukses më të mirë në punë.

Në fund të trajnimit, nga këndvështrimi i Njesisë së Inspeksionit Gjyqësor u prezantuan disa raste nga praktika që pasqyrojnë sjellje të pahijshme të gjyqtarëve.

Për të gjitha komentet, analizat, sugjerimet dhe plotësimet na shkruani në e-mail adresën: kji_newsletter@hotmail.com

- specializimi i gjyqtarëve, prokurorëve dhe policëve për të mitur. shfrytëzimi i të gjitha mundësive tjera për të shmangur dënimin për të miturit.

Regjioni i Pejës – tema e njëjtë u trajtua me datën 07 dhjetor 2007 edhe në regjionin e Pejës. Nga konstatimet kryesore të këtij seminari mund të veçohen:

- në regjionin e Pejës për çdo rast kur i mituri bie ndesh me ligjin njoftohet organi i kujdestarisë.

- zakonisht nga policia kërkohet që për çdo vepër penale të bëhet një raport i cili mandej duhet dërguar prokurorit i cili është ai që duhet të vendosë se a duhet pezulluar procedurën, shqiptuar masën e diverzitetit ose dërgimin rastit në gjykatë.

- gjatë gjithë procedurës duhet shmangur veprimeve nënçmuese ndaj të miturit.

Simulim gjykimi në lëmin civile

Me datën 11 dhjetor 2007 Instituti Gjyqësor i Kosovës në Gjykatën e Qarkut në Prishtinë organizoi një simulim të gjykimit me temën “Kompensimi i dëmit material dhe jo material”.

Veprimet procedurale që u paraqitën në këtë simulim adresuan tek pjesëmarrësit rekomandime të dobishme. Gjatë debatit u analizua secili veprim procedural i palëve me argumente pro et contra. U trajtua gjithanshëm dëmi si një ndër burimet e marrëdhënieve të detyrimeve, me ç'rast u tha se marrëdhënia juridike e detyrimit për shpërblimin e dëmit lind nga fakti se dikujt i është shkaktuar dëmi, i cili duhet t'i shpërblehet.

Praktika e gjykatave ka treguar se si rrethana të cilat mund të ndikojnë në caktimin e lartësisë së dëmit për shkak të dhembjeve fizike mund të jenë edhe bezdisjet gjatë shërimit (p.sh. humbja e vetëdijes, hospitalizimi, të lidhurit

për shtrat, mobilizimet të ndryshme dhe fiksime, incizimet rëntgenologjike, operacionet, infuzionet, transfuzionet, injeksionet, lidhja e plagëve, largimi i fashave, përdorimi i karrocave individuale, pushimi mjekësor, vizitat ambulatorë, fizioterapia) të cilat i pëson i dëmtuari në kontekst me dhembjet fizike.

Lëshimi i gjykatës që në arsyetimin e aktgjykimit të paraqet të gjitha arsyet të cilat kanë ndikuar në caktimin e lartësisë së shpërblimit të dëmit jomaterial në kuptim të nenit 200 par.1 të LMD, përfaqësojnë shkelje thelbësore të procedurës, për të cilën arsye aktgjykimi duhet prishur dhe lënda t'i kthehet gjykatës së shkallës së parë për rigjykim. Gjykata dhe ekspertët gjyqësor intensitetin e

të ekzistojnë tri prezumime: pronësia e paditësit, identiteti i sendit dhe posedimi i sendit nga i padituri.

- Në gjykata ka shumë konteste të cilat zhvillohen sipas kërkesave nga paditë e reivindikimit. Problem i veçantë për vendosjen lidhur me ato konteste paraqitet fakti i vërtetimit të së drejtës së pronësisë, sidomos në sendet e paluajtshme në situatat kur paditësi nuk posedon provë për të drejtën e pronësisë për sendin dorëzimin e të cilit e kërkon por edhe për faktin se institucionet e Kosovës nuk kanë në disponim librat e kadastrit në bazë të cilave do të vërtetoheshin faktet relevante lidhur me kontestet e cekura.

- Qëllimi i padisë negatore (Actio negatoria) është pezullimi dhe ndalimi i pengimit që është i pranishëm, dhe ndalimi i pengimeve në të ardhmen, nën kërcënim të dënimin me të holla. Me këtë padi kërkohet: kthimi në gjendje të mëparshme (kur me veprim është krijuar një situatë e re materiale), pezullimi i sjelljeve me të cilat bëhet pengimi apo trazimi (ndalimi i kalimit nëpër oborrin e paditësit) dhe ndalimi i trazimeve dhe pengimeve të mëtejme.

- Në raste të imisioneve të tepërta (zhurma e madhe, pluhuri i madh, era e padurueshme) pronari mund të kërkojë ndërmarrjen e masave adekuate, teknike me të cilat imisionet kthehen në nivele të tolerueshme (p.sh. instalimi i aparateve që mos të përhapet pluhuri, zhurma apo gazrat e dëmshme).

- Edhe pse LMBPJ nuk e thotë shprehimisht, duhet kuptuar se ndërprerja e pengimit përfshinë edhe ndalimin e pengimit në të ardhmen.



- Në kontestin midis pronarit të supozuar dhe poseduesit të sendit përballen bazat juridike për posedimin e sendit. Mbrojtjen pronësore përfiton ai i cili e ka bazën më të fortë për posedimin e sendit.

- Padia publiciane është mjet në kontestin midis dy pjesëmarrësve rreth posedimit të sendit në të cilin asnjëri nuk mund të argumentojë se ka të drejtën në send, por poseduesit me bazë më të fortë në posedim i ndahet sendi. Poseduesi i cili e ka fituar sendin me punë juridike barrësore, e ka bazën më të fortë nga ai i cili e fitoi me punë juridike jobarrësore.

Në kontestin sipas padisë me të cilën kërkohet njohja e pronësisë kundër poseduesit të sendit paditësi duhet të argumentojë që ai ose paraardhësi i tij e ka fituar sendin nga pronari i vërtet me bazë juridike të vlefshme dhe në mënyrë ligjore. Në rast të dyshimit merret se e drejta është në anën e poseduesit të sendit.

-

3 **Tryezë diskutimesh me ekspertët e lëmisë penale**

Më datë 02 nëntor 2007 është organizuar një tryezë diskutimesh ku pjesëmarrës ishin gjyqtarë të Gjykatës Supreme të Kosovës, prokurorë të Prokurorisë Publike të Kosovës, prokurorë të Prokurorisë Speciale, përfaqësues të Shoqatës së Gjyqtarëve të Kosovës, përfaqësues të Shoqatës së Prokurorëve të Kosovës dhe trajnues gjyqësor të IGJK-së, Qëllimi i kësaj tryeze ishte përmbledhja e propozimeve për temat nga lëmia penale të cilat do të përfshihen në Programin e Vazhdueshëm të Trajnimeve për vitin 2008.

Përveç temave të shumta të propozuara për trajtim në vitin

2008, pjesëmarrësit së bashku me përfaqësuesit e IGJK-së erdhën në përfundim se për të qenë i suksesshëm programi i trajnimeve duhet ti ketë disa veçori:

- të thellohet edhe më shumë bashkëpunimi me eprorët e institucioneve përkatëse.
- temat te cilat përcaktohen të jene te profilizuara ne institute te veçanta.
- trajnuesit duhet të takohen së bashku së paku një herë para trajnimit dhe
- trajnimet të jenë kryesisht praktike.

Seminar për gjyqtar porotë

Me datën 06 nëntor 2007, u organizua seminari dedikuar gjyqtarëve porotë për regjionin e Gjilanit. Fakti se pa gjyqtarë porotë për disa çështje civile dhe për disa kategori të veprave penale nuk mund të mbahet shqyrtimi gjyqësor tregon se sa ata janë të rëndësishëm për funksionimin e gjykatave. Prandaj kërkohet që sikurse gjyqtari profesionist edhe gjyqtari porotë të japë kontributin e tij në mënyrë që të arrihet në zbatimin e drejtë të ligjit dhe marrjen e vendimit të drejtë gjyqësor. Ndër çështjet që mund të cilësohen si brenga të gjyqtarëve

porotë, nga ky trajnim mund të veçohen:

- mos njoftimi me lëndën paraprakisht,
- mos dërgimi i ftesave me rregull,
- mos kompensimi me kohë,
- mungesa e zyrave që rezultojnë me pritje të gjata nëpër korridore,
- nevoja e trajnimit (të kenë së paku dy herë trajnime në vit).

edhe i pandehuri.

- i pandehuri duhet të ulet gjithnjë afër mbrojtësit, me qëllim që të realizohet funksioni i mbrojtjes dhe për shkak se gjatë kohës kur zhvillohet procedura penale i pandehuri ndodhet në një gjendje të posaçme shpirtërore.

përveç nenit 72 të KPPK-së, gjykata ex officio mund ta bëjë një përjashtim të mbrojtësit në rastet kur mbrojtësi është pasiv dhe nuk interesohet për mbrojtje efektive të pandehurit.

Në këtë tryezë u shfaqën dy lloj mendimesh lidhur me çështjen e mbrojtjes. Sipas mendimit të parë, personi i arrestuar, gjatë gjithë kohës derisa është në arrest të përkohshëm ose në ndalim policor duhet të ketë mbrojtës. Ndërsa sipas mendimit të



dytë, mbrojtja për personin e arrestuar ose të ndaluar, përjashtimisht është e detyruar dhe atë kur personi i arrestuar ose i ndaluar është memec, shurdh ose kur shfaq shenja të çrregullimit ose paaftësisë

mendore, ndërsa në rastet tjera mbrojtja nuk është e detyruar, ndërsa deklaratat e marra nga policia ose prokurori publik pa praninë e mbrojtësit janë të vlefshme dhe prova të pranueshme, me kusht që personi i arrestuar ose i ndaluar të jetë i njoftuar me këtë të drejtë dhe ai, në mënyrë të qartë dhe me dëshirën tij të heq dorë nga kjo e drejtë.

Delikuenca e të Miturve

Regjioni i Prizrenit IGJK-ja në bashkëpunim me UNICEF-in me datën 06 dhjetor 2007 organizoi seminarin me temën Delikuenca e të Miturve. Qëllimi kryesor i këtij trajnimi ishte harmonizimi dhe bashkëpunimi më i mirë i subjekteve të cilët marrin pjesë në procedurën për të mitur, në favor të mbrojtjes së interesit më të mirë të të miturit. Konstatimet kryesore të këtij seminari ishin:

- Mungesa e bashkëpunimit në mes të këtyre subjekteve, pasi që shpesh

herë organi i kujdestarisë është i njoftuar nga prokurori, por janë të anashkaluar nga gjykata.

- nevoja e shqiptimit më të shpeshtë të masave të diverzitetit të cilat sipas të dhënave statistikore nuk shqiptohen fare nga prokurori në këtë regjion

- nevoja e ndryshimit të ligjit duke shtuar masa të tjera të diversitetit.

e dispozitave ligjore dhe të drejtave të pandehurit.

Nga pjesëmarrësit e trajnimit është propozuar që instituti i negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të përfshij edhe dënimin dhe të emërtohet si *instituti i negocimit të marrëveshjes për pranimin e fajësisë*

dhe dënimin. Kjo është arsyetuar me faktin se për të pandehurin është me interes të përfshihet edhe dënimi, sepse i pandehuri ndihet i pasigurt ta pranoj fajin kur nuk e din çmimin.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Për dy ditë me radhë, më datë 04-05 dhjetor 2007 në regjionin e Prishtinës është mbajtur seminari mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në të cilin seminar temë e trajtimit ka qenë neni 5 dhe 6 i kësaj konvente. Përfitues të këtij seminari ishin gjyqtarët dhe prokurorët nga ky regjion.

Me rastin e interpretimit të këtyre neneve është theksuar se pikërisht këto dy nene gjejnë zbatim më së shumti në punën e përditshme të gjyqtarëve dhe prokurorëve dhe se



përmbajtje të ngjashme hasen edhe në dispozitat e Kodit të Procedurës Penale edhe për këtë arsye edhe Gjykata e Strasburgut e bënë një interpretim mjaft të gjerë për faktin se janë të një rëndësie të madhe. Si konstatim doli se Gjykata e Strasburgut nuk i ndryshon vendimet e gjykatës vendore por vetëm konstaton shkeljet dhe rekomandon shtetin për kompensimin e dëmit.

Mbrojtja ligjore

Instituti Gjyqësor i Kosovës me datë 06 dhjetor 2007 organizoi një tryezë diskutimesh lidhur me mbrojtjen ligjore. Nga vështrimi analitik që iu bë mbrojtjes ligjore dolën këto përfundime:

- i pandehuri si subjekt qendror në procedurën penale, në raport me

paditësin e autorizuar është palë e barabartë. Kjo barabarësi shihet nga fakti se për të pandehurin ekziston prezumimi i pafajësisë.

pavarësisht nga vështirësitë me të cilat ballafaqohen gjykatat, kur caktohet mbrojtësi sipas detyrës zyrtare, duhet të njoftohet me rastin

Tryezë diskutimesh me ekspertët e lëmis civile

Me datë 07 nëntor 2007 u mbajt takimi me ekspertët e lëmis civile (gjyqtarë të Gjykatës Supreme, të gjykatave të qarkut, gjykatave komunale dhe avokat të mirënjohur) në funksion të identifikimit të nevojave të gjyqtarëve të lëmis civile me qëllim të ngritjes profesionale të tyre.

Në takim u zhvillua një debat konstruktiv i cili rezultoi me propozime dhe sugjerime për tema konkrete, por gjithashtu u sugjeruan edhe disa teknika te veprimit të IGJK-së ndër të cilat mund të përmenden:

- Gjykata Supreme e Kosovës duhet të jetë më e inkuadruar në hartimin e planifikimit për trajnime.

- në bashkëveprim me kryetarët e gjykatave të ndikohet në trajnimin e atyre gjyqtarëve që nuk marrin pjesë fare në trajnime.

- IGJK-ja gjatë vitit 2007 ka dhënë kontribut të konsiderueshëm në lëmin e trajnimit të vazhdueshëm për gjyqtarët dhe prokurorët e Kosovës.

- në të ardhmen në trajnime të ftohen edhe avokat me përvojë që do të mund të kontribuonin dukshëm me përvojën e tyre.

- u shpreh respekt për materialet që IGJK-ja me kohë i shpërndan, siç janë; programet, pyetësorët për vlerësim te nevojave, buletinet mujor, ftesat etj.

- u përkrah mënyra e bashkëbisedimeve direkte mes IGJK-së dhe gjyqtarëve për nevojat e tyre në sferën e trajnimeve.

Nga përfaqësuesit e IGJK-së në lëmin e metodologjisë u kërkua një angazhim më i madh i ekspertëve në drejtim të përdorimit të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe koordinimit e bashkëpunimit më të mirë në mes të ekspertëve.

Parashkrimi i ndjekjes penale

Tryeza e diskutimeve me temë Parashkrimi i ndjekjes penale ishte ngjarja trajnuese e radhës e cila u organizua më 8 nëntor 2007. Nga diskutimet e shumta në këtë tryezë mund të veçohen:

- në praktikë po ndodhë që të ngatërrohet parashkrimi absolut me atë relativ,

nëse është në pyetje pushimi i ndjekjes penale atëherë afati i parashkrimit zgjatet,

- për aq kohë sa ka pushuar ndjekja penale,

- në atë se a mund të konsiderohet ftesa veprim procedural i cili do ta ndërpres parashkrimin apo jo, u

mbrojt qëndrimi se ftesa e ndërprende afatin e parashkrimit sepse ajo është veprim procedural që ka të bëjë me ndjekjen penale,

- baza ligjore për të mos rrjedh parashkrimi mund të ekzistoj te imuniteti i deputetit, shtyrja e dënimit me burgim sipas dispozitave të Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, pastaj rasti i mundësisë së shtyrjes të mbajtjes së dënimit për shkak të moshës së fëmijës ose shtyrja e dënimit sipas kërkesës të PPK ose të vendimit të gjykatës lidhur me mjetet e jashtëzakonshme juridike,

- si veprime të cilat e ndërpresin parashkrimin mund të përmendet ftesa e cila i është dërguar të gjykuarit për fillimin e vuajtjes së dënimit, dhënia e urdhërësës për të detyruar të gjykuarit në vuajtje të dënimit, lëshimi i letërreshtimit vendor dhe ndërkombëtar, etj,

Tryezë diskutimesh për gjyqtarët e gjykatave për kundërvajtje

Me datën 13 nëntor 2007 u mbajt tryeza e diskutimeve nga lëmia e kundërvajtjes ku përfitues ishin gjyqtarët për kundërvajtje. Gjatë këtij trajnimi u arritën disa përfundime, si:

- Ligji mbi Kundërvajtjet përmban vetëm disa nene që kanë të bëjnë me të miturit, prandaj zbatohet edhe Ligji për të Miturit si dhe Konventat ndërkombëtare që i dedikohen kësaj kategorie.

- me Ligjin për Kundërvajtjet është paraparë zëvendësimi i dënimit me gjobë me dënimin me burg por kjo me

- ekzekutimi i dënimit me gjobë parashkruhet në afat prej 2 viteve, ndërsa sa i përket parashkrimit të ekzekutimit të dënimeve plotësuese dhe masave të trajtimit të detyrueshëm u theksua se ligjdhënësi ka parashikuar afate të veçanta kohore, ekzekutimi i masave të trajtimit të detyrueshëm nuk mund të bëhet pas skadimit të afatit prej tri vitesh nga dita kur aktgjykimi për shqiptimin e këtyre masave është bërë i formës së prerë,

- ekzistimi i problemeve si mos efektiviteti i administratës gjyqësore, moszbatimi i urdhrit nga ana e policisë, mos dorëzimi me kohë i aktgjyqimeve dhe një varg çështjesh tjera teknike.

Ligjin Penal për të mitur nuk lejohet ngase gjithmonë duhet të vijë në shprehje interesi më i mirë i të miturit.

- Organi i Kujdestarisë duhet të jep mendimin profesional se a janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore që ndaj të miturit të shqiptohet masa edukative si dhe të respektohet procedura duke marr parasysh anën psiko-fizik dhe ndjeshmëria e të miturit.

-

ndërgjegjësuese.

Gjithashtu u bë një vështrim i interpretimit të dispozitave të Kodit të Procedurës Penale që kanë të bëjnë me dëshmitarët e mbrojtur dhe anonim si dhe me dëshmitarët bashkëpunues, dispozita që më së shumti ndihmojnë në luftimin e suksesshëm të trafikimit me njerëz.

Gjatë këtij seminari u prezantua edhe

një film dokumentar, me dëshmitë e dy viktimave të trafikuar dhe një film i cili trajtonte po ashtu viktimat e trafikuar, trafikantët, metodat që përdorin ata dhe qëllimet kryesore të tyre.

Në fund të këtij trajnimi për pjesëmarrësit u shpërndanë certifikata.

Tryezat lidhur me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës

Instituti Gjyqësor i Kosovës me datë 29, 30 nëntor dhe 1 dhjetor si dhe me datë 13, 14 dhe 15 dhjetor 2007, ka organizuar tryeza të rumbullakëta në nivel ekspertesh lidhur me Kodin e Përkohshëm Penal të Kosovës.

Nevojat dhe kërkesat e praktikës gjyqësore për të sqaruar disa dilema të cilat po hasen në zbatimin e së drejtës materiale, e kanë nxitur IGJK-në që të organizojë këto tryeza. Qëllimi i këtyre tryezave është që pas diskutimit dhe analizimit të

dispozitave të KPPK të bëhen propozime konkrete për plotësimet dhe ndryshimet eventuale të këtij kodi. Tryezat e tilla do të vazhdojnë edhe në vitin 2008, në mënyrë që këto përpjekje serioze të kurorëzohen me zgjidhje konkrete, të cilat më pas do tu dërgohen institucioneve kompetente për të vendosur.

Negocimi i marrëveshjes për pranimin e fajësisë

Në bashkëpunim me Departamentin e Drejtësisë të SHBA-ve zyra në Prishtinë, me datën 3 dhjetor 2007 u organizua një trajnim praktik, lidhur me negocimin e marrëveshjes për pranimin e fajësisë. Gjatë trajnimit u theksua se ky institut do të ndikoi në:

- zvogëlimin e ngarkesës së gjykatave me lëndë.

- ekonomizimin e procedurës.

- rehabilitim e kryesit të veprës penale.

- eliminimin e pasigurisë të pandehuri lidhur me përfundimin e procedurës, etj.

Për çdo marrëveshje të arritur në mes prokurorit dhe mbrojtësit, gjykata duhet të ketë kujdes për respektimin

Mungesa e mbrojtjes gjyqësore nga njerëzit e painformuar është arsyetuar me mungesën e infrastrukturës ligjore.

Kjo materie tani rregullohet me Ligjin për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e tjera të Përafërta nr. 2004/45 i miratuar nga Kuvendi i Kosovës me 29.06.2006.

Gjatë diskutimeve u trajtua natyra juridike e të drejtës së autorit dhe të drejtat që rrjedhin nga ajo, si trajtohet ajo në legjislacionin e shteteve në rajon dhe më gjerë, çfarë parasheh Ligji për të Drejtat e Autorit dhe të Drejtat e Tjera të Përafërta dhe dispozitat tjera ligjore që i referohen kësaj kategorie të të drejtave.

U trajtua gjithanshëm bartja e të drejtës së autorit, vëllimi dhe bazat e

bartjes së të drejtës së autorit, kontrata dhe rregullat e përgjithshme të kontratës së autorit, llojet e kontratave të autorit, rregullat e veçanta të kontratës së autorit, kontrata e botimit, kontrata për paraqitjen-ekzekutimin e veprës së autorit, kontrata për veprën kinematografike, bartja e të drejtës së autorit në bazë të trashëgimisë, objekti i cenimit të drejtës së autorit, e drejta morale e autorit, e drejta pasurore e autorit, format e cenimit të veprës së autorit, personat të cilët kanë të drejtën e shpërblimit të dëmit, baza juridike për shpërblimin e dëmit, lartësia e shpërblimit të dëmit, etj.

Trafikimi me Qenie Njerëzore

Me datë 29 dhe 30 nëntor 2007, IGJK në bashkëpunim me IOM-in organizoi sesionin trajnues dy ditor lidhur me Trafikimin me Qenie Njerëzore.

Trafikimi i qenieve njerëzore vjen për shkak të një sërë faktorëve të cilët sipas pjesëmarrësve janë: varfëria, mungesa e perspektivës për të ardhmen, mungesa e mundësive ekonomike në vendin e origjinës, mungesa e arsimimit dhe informacionit të drejtë, dhuna dhe abuzimi në familje. Po ashtu u bë dallimi ndërmjet prostitucionit dhe trafikimit.

Në bazë të analizave statistikore që disponon IOM-i kemi rritje të numrit

të viktimave vendore për 150 % në krahasim me vitet e kaluara nga 6 sa kanë qenë në 2000, në vitin 2006 kanë qenë 30, ndërsa deri në shtator të vitit 2007 janë evidentuar 15 raste.

Në kudër të fushëveprimit të vet IOM-i në Kosovë ka ofruar asistencë për kthimin dhe ri-integrimin e viktimave të huaja dhe vendase (566 raste), mbledhje të dhënash dhe hulumtime, në ngritjen e kapaciteteve për institucionet dhe sektorin jo-qeveritar, si dhe parandalimi i trafikimit nëpërmjet informimit dhe aktiviteteve

- përfaqësuesi i të miturit duhet të jetë ekskluzivisht avokat i regjistruar në OAK, pedagog, psikolog, etj.

- në rastin kur i mituri vuan nga ndonjë sëmundje shpirtërore duhet ndërprerë procedurën menjëherë.

- veçanërisht duhet kushtuar kujdes mos cenimit të parimit të publicitetit në procedurën ndaj të miturve si dhe nuk duhet përdorur termi fajtor për të miturin por duhet përdorur termi përgjegjës.



- në raste kur i mituri kryen dy vepra duhet vetëm të përshkruhen veprat kundërvajtëse ndërsa të

miturit i shqiptohet një dënim që është më i larti për një raste veprë kundërvajtëse,

- kur shqiptohen masat edukative ato duhet të jenë të përkufizuara në aspektin kohor, si dhe kur të miturit i shqiptohet gjoba nuk mund ti shqiptohet masa edukative.

Dhuna në Familje

Me datën 14 nëntor 2007 u mbajt tryeza me temën "Dhuna në Familje". Përfitues të kësaj tryeze ishin gjyqtarët e lëmis civile të të gjitha regjioneve të Kosovës, zyrtarë të SHPK-së që punojnë në këtë lëmi, zyrtarë të Qendrave për Punë Sociale, avokatë, etj.

Në këtë tryezë u trajtua nocioni i familjes dhe marrëdhënieve familjare, si është i mbrojtur individ i familje nga rastet arbitrare, kur mund të ndërhyhet në jetën private, në cilat raste, me çfarë baze dhe qëllimi mund të ndërhyhet.

U potencua se viktimat më të shpeshta janë gratë dhe fëmijët andaj edhe kësaj kategorie rëndësi të posaçme ju

kushtohet në Konventën për Eliminimin e të gjitha formave të Diskriminimit ndaj Grave (KEDNG – është miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB -së nr. 34/180 më 18.12.1979) dhe Konventa për të Drejtat e Fëmijës (KDF–e miratuar me Rezolutën e Asamblesë së Përgjithshme të OKB -së nr. 44/25 më 20.11.1989). Ndërmarrja e masave të nevojshme nga shtetet për të luftuar dhunën në familje kërkohet edhe me Konventën Evropiane për të drejtat e njeriut (KEDNJ).

Në përputhje me detyrimet nga këto konventa, më 09.05.2003 është shpallur në fuqi Rregullorja e UNMIK -ut nr. 2003/12 për Mbrojtjen Kundër Dhunës në Familje, sipas së cilës viktimat e dhunës në familje mund të kërkojnë nga gjykata caktimin e masave mbrojtëse me qëllim të evitimit të dhunës dhe realizimit të drejtave dhe përmbushjes së detyrimeve nga Ligji për Familjen i Kosovës.

Në këtë mënyrë dhe nga kjo arsye, në rast të paqartësive në këtë rregullore, për interpretim të drejtë të saj, duhet konsultuar dispozitat nga konventat e mësipërme, Ligjin për Familjen të Kosovës dhe Ligjin e Procedurës Kontestimore i cili zbatohet në rastet kur për çështjet e caktuara kjo rregullore nuk përmban dispozita të veçanta.

Në diskutim e sipër nga ky trajnim u konkludua se:

- është e nevojshme që në sa më shumë raste të vendoset me masa të përkohshme në kontestet e iniciuara në gjykata, qoftë në kontestet martesore apo kontestet e ndara për ushqim,

masat mbrojtëse mund të caktohen nga ana e gjykatës me urdhër për mbrojtje apo urdhër për mbrojtje emergjente si dhe me urdhër për mbrojtje emergjente të përkohshme të lëshuar nga komandanti kujdestar ose ushtruesi i detyrës së komandantit të njësitit rajonal të policisë.

- nëse me këtë rregullore nuk janë paraparë rregulla të veçanta procedurale, zbatohen rregullat nga Ligji i Procedurës Kontestimore (LPK). Procedura e paraparë sipas Rregullores është procedurë civile.

- me shkeljen në tërësi apo vetëm pjesërisht të ndonjërit nga urdhrat e paraparë me këtë Rregullore pala përgjegjëse kryen vepër penale e cila ndiqet sipas detyrës zyrtare,

- zgjidhja më e mirë për luftimin e dhunës në familje u potencua se qëndron në zbatimin e efektshëm dhe konsekuent të dispozitave të kësaj rregulloreje dhe me këtë do të zvogëloheshin edhe problemet tjera të shumta të dhunës në familje në Kosovë.

Në debat lidhur me këtë temë u potencuan edhe lëshimet dhe dobësitë që po vërehen nëpër gjykata si: vonesat e caktimeve të seancave gjyqësore, përfaqësimi ligjor dhe mbrojtja sociale jo adekuate e fëmijëve gjatë procedurave ligjore, e drejta për gjykim publik, përbërja jo e duhur e trupit gjykues, arsyetimet e pamjaftueshme të aktvendimeve për caktimin e masës mbrojtëse etj.

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Për dy ditë me radhë më datë 26 dhe 27 nëntor 2007, në regjionin e Mitrovicës është mbajtur seminari mbi Konventën Evropiane për të Drejtat e Njeriut, në të cilin temë e trajtimit ka qenë neni 5 dhe 6 i kësaj konvente. Gjatë interpretimit të nenit 5 të Konventës Evropiane përveç tjerash u theksua se paragrafi 1 i këtij neni ka një prezumim në favor të lirisë të cilin e përmban edhe Kodi i Procedurës Penale të Kosovës, me rastin e sigurimit të prezencës së të pandehurit në procedurë..

Nga vështrimi i bërë raportit të OSBE-së mbi monitorimin e sistemit gjyqësor në Kosovë ku është konstatuar se ka mjaftë shkelje sa i përket paraburgimit, mos arsyetimit të vazhdimit të paraburgimit, del që:

- për të vazhduar paraburgimin gjithashtu duhet të ekzistojë kërkesa, sepse në të kundërtën pa kërkesë nuk ka vazhdim të paraburgimit.

- nuk ka paraburgim derisa nuk është vërtetuar dyshimi se është kryer vepra penale.

E Drejta e Autorit

Më datën 29 nëntor 2007 është mbajtur seminari nga lëmia civile me temë "E Drejta e Autorit" në të cilin vëmendja kryesore u përqendruan në çështjet që kanë të bëjnë me të drejtat që rrjedhin nga vepra e autorit, bartjen e të drejtës së autorit, shpërblimin e dëmit për shkak të cenimit të së drejtës së autorit, etj.

E drejta e autorit gëzon mbrojtje juridike jo vetëm me ligjin vendor, por

paraburgimi nuk mund të caktohet më shumë se 30 ditë.

Gjatë analizimit të nenit 6 të kësaj konvente barra e përgjegjësisë bie te gjyqtarët të cilët gjatë seancës duhet të sigurohen se:

- a është respektuar parimi i barazisë së armëve,

- a është përfaqësuar i pandehuri në mënyrë të duhur,

- a është njoftuar i pandehuri me kohë për akuzën,

a janë ofruar lehtësitë për mbrojtjen e tij etj,

Nga këto pika të theksuara më lartë mund të konstatojmë se neni 6 zbatohet në të gjitha fazat e procedurës nga ato që i paraprijnë procesit gjyqësor e deri te ato që pasojnë pas procesit gjyqësor.

edhe ndërkombëtar. Mbrojtja e kësaj të drejte përveç ekzistimit të rregullativës juridike, varet edhe nga shumë rrethana tjera, e para së gjithash nga zbatimi i drejtë i ligjeve.

Në Kosovë ka ekzistuar dukuria e cenimit të drejtave të autorit me përmasa të mëdha.

Tryezë diskutimesh nga lëmia civile

Hipoteka dhe Pengu kanë qenë temë e tryezës së organizuar nga Instituti Gjyqësor i Kosovës me datën 22 nëntor 2007 përfitues të së cilit ishin gjyqtarët e lëmis civile të të gjitha regjioneve të Kosovës.

Temat të cilat u trajtuan gjatë punës së kësaj tryeze u përqendruan në çështjet që kanë të bëjnë me hipotekën dhe rëndësinë e saj në sigurimin e kërkesave, masat e përkohshme, përmbarimin në paluajtshmëri dhe praktikën gjyqësore lidhur me këto çështje.

U theksua se në çdo sistem juridik ku ekziston ekonomia e tregut, një vend shumë të rëndësishëm ka edhe hipoteka e cila mundëson sigurimin e kërkesave të kreditorëve. Hipoteka si institut juridik mundëson një zhvillim normal të ekonomisë duke krijuar kushte për investime të sigurta.

Gjatë diskutimeve në këtë tryezë u trajtuan natyra juridike e të drejtës së pengut në Kosovë, pozita e kësaj të drejte në legjislacionin e shteteve në rajon dhe më gjerë. U theksua se në Kosovë, përveç Ligjit mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore-Juridike, ligj i aplikueshëm është edhe Rregullorja e UNMIK-ut për Pengun mbi Pasurinë e Luajtshme nr. 2001/05, Ligji mbi Hipotekën i shpallur në fuqi me RREG. UNMIK 2002/21 dhe dispozitat tjera që gjenden në Ligjin mbi marrëdhëniet e detyrimeve dhe në Ligjin mbi procedurën përmbarimore.

Legjislacioni i sotëm si ai i brendshëm dhe ai ndërkombëtar shkojnë nga ajo

që të favorizojnë kreditorin çka në të kaluarën ishte e kundërta, favorizohej debitorin.

Ishte interesant paraqitja e faktit se Ligji i ri mbi Hipotekën i shpallur me 20.12.2002 thuhet se nuk është zbatuar fare që më se pesë vite.

Në këtë tryezë u trajtuan gjithanshëm koncepti i ri mbi hipotekën, rëndësia e saj, objekti i saj, cilësitë dalluese të saj prej të drejtave tjera sendore.

U shtjelluan edhe mënyrat e fitimit të hipotekës, bartja e të drejtës së hipotekës, shuarja e hipotekës, pastaj hipoteka e përbashkët, të drejtat e kreditorit hipotekues dhe të drejtat e pronarit të sendit..

Në fund u trajtuan rastet kur ekziston përjashtimi nga përmbarimi, caktimi i vlerës së paluajtshmërisë, mënyra dhe kushtet e shitjes së paluajtshmërisë, e drejta e parablerjes, si bëhet pagesa e kreditorëve si dhe dispozitat e veçanta mbi mënyrën e përmbarjes së disa kërkesave.

Trafikimi me qenie njerëzore

Në bashkëpunim me UNDP-në u organizua një trajnim dy ditor lidhur me trafikimin e qenieve njerëzore, i cili u mbajt me datë 14-15 nëntor 2007 në Strugë të Maqedonisë, në kudër të së cilit sesion u theksua se:

- Sipas KPPK-së, të gjitha çështjet që kanë qenë të rregulluara me Rregulloren e UNMIK-ut 2001/4, e që janë mbuluar më KPPK nuk janë më në fuqi. Ndërsa për ato çështje të cilat nuk i mbulon KPPK, duhet aplikuar dispozitat e rregullores së UNMIK-ut 2001/4 (neni 354 i KPPK).

- U bë një vështrim i dallimit në mes veprës penale të trafikimit me qenie njerëzore dhe kontrabandimit me emigrant dhe u theksua se ligji nuk e njeh shprehjen trafikim me emigrant por atë kontrabandim me emigrant.

- Dilemë tjetër ishte kalimi ilegal i kufirit ndërsa kontrabandimi mund të kryhet edhe nëpër pika kufitare dhe të mos jetë ilegal, p.sh. kalon me pasaportë të falsifikuar.

- Në situatën kur viktimës nuk i sigurohet “mbrojtës”, sepse e ka “përfaqësuesin” nga divizioni për mbrojtje të viktimave u theksua se kjo nuk konsiderohet shkelje e të drejtave të viktimës dhe shkelje e dispozitave të KPPPK.

Mirëpo mendimi i Gjykatës Supreme të Kosovës dhe Prokurorisë së Kosovës është se kjo konsiderohet si shkelje relative dhe nëse si e tillë ka ndikuar në marrjen e vendimit, atëherë në bazë të kësaj shkelje mund të priset

aktgjykimi dhe të kthehet lënda në rigjykim.

- Gjatë marrjes në pyetje të viktimave duhet që procesverbali të shkruhet ashtu siç deklarohet viktimat,

- Kërkesa pasurore-juridike është e drejtë e viktimës së trafikuar,

- Në lidhje me dispozitën e nenit 143 i LPMK u theksua se nëse nuk respektohet kjo dispozitë atëherë prova e marrë mund të konsiderohet si e papranueshme,

- Te vepra penale e trafikimit me njerëz kur viktimë na paraqitet fëmijë, pëlqimi nuk merret për bazë,

- Nga dispozita e nenit 143 paragrafi 2 i LPMK shihet se fëmija nuk mund të merret në pyetje më shumë se dy herë, sepse konsiderohet shkelje që nga momenti kur fillon procedura penale.

- dënimet e shqiptuara nuk janë adekuate dhe në nivel me peshën e veprës penale, me ç'rast u mbrojt qëndrimi se rolin kyç për ta ndryshuar një politikë të tillë të dënimeve mund të luaj Gjykata Supreme e Kosovës.

9 **Seanca e shkallës së dytë (simulim gjykimi)**

Më datën 20 nëntor 2007 IGJK-ja organizojë një trajnim nga lëmia penale, me temën seanca e shkallës së dytë ku përfitues ishin gjyqtarët dhe prokurorët e regjionit të Mitrovicës,

Pjesa e parë e trajnimit ishte simulimi i seancës së shkallës së dytë, ndërsa më pas fillojë diskutimi lidhur me rastin e simuluar.

Gjatë diskutimeve u theksuan këto përfundime:

- aktgjykimi përmbante shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale sepse nuk kishte arsye për faktet vendimtare,
- ankesa e prokurorit publik komunal si rrethana rënduese i cek elementet qenësore të veprave penale. Ndërsa sa i përket ankesës së të dëmtuarit është vërejtur se pjesa që ka të bëjë me dëmin duhet hedhet sepse me ligj nuk është e lejuar, por nëse i akuzuari ka precizuar dëmin që i është shkaktuar dhe ka paraqitur kërkesë pronësoro-juridike, nuk është i ligjshëm vendimi i gjykatës,
- sa i përket asaj se mbrojtësi i të

akuzuarit, përkundër faktit se nuk ekziston ankesa e të akuzuarit, u ftua në disa shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, përfundimi i pjesëmarrësve ishte se ai nuk mund të del nga suazat e përgjegjës në ankesë, por megjithatë, nëse kryetari i kolegjit këtë e ka lejuar, mbrojtësi në mënyrë indirekte ka përkujtuar gjykatën për ato shkelje të cilat shqyrtohen detyrimisht,

- kur i akuzuari e pranon fajësinë dhe gjykata pajtohet me këtë pohim, ndërsa nga shkresat e lëndës del se nuk ka pasur bazë për pranim, gjykata nuk është dashtë të pajtohet me këtë pohim,
 - zakonisht në vendimet e shkallës së parë nuk janë duke u arsyetuar elementet qenësore të veprës penale,
- Gjatë këtij trajnimi u shtruan shumë pyetje dhe u diskutua për disa çështje specifike të cilat e karakterizojnë praktikën e regjionit të Mitrovicës.

Delikuenca e të Miturve

Regjioni i Prishtinës - në bashkëpunim me UNICEF-in me datën 22 nëntor 2007 organizoi tryezën e diskutimeve me temë Delikuenca e të Miturve ku përfitues ishin gjyqtarët, prokurorët, zyrtarët e shërbimit sprovues dhe pjesëtarë të SHPK-së nga regjioni i Prishtinës.

Në këtë tryezë u diskutuan aspektet e delikuençës së të miturve duke filluar nga njoftimi për rastin deri tek marrja dhe ekzekutimi i dënimeve dhe masave për të miturit kur ata janë kryes të veprave penale. Nga kjo tryezë mund të veçohen këto çështje:

- të gjitha subjektet që janë palë në procedurën për të mitur duhet të bashkëpunojnë më shumë në mes vete sepse prokurori ka për obligim që ta njoftojë organin e kujdestarisë për çdo rast në mënyrë që kjo të ketë një evidencë, e po ashtu edhe shërbimin sprovues, në mënyrë që të dihet se kush është i mituri, nga çfarë familje është etj, e në këtë kontest edhe policia duhet ti dërgoj raportin prokurorit që ky mandej ta ketë mundësinë e vazhdimet të veprimeve të tjera të nevojshme.

- nëse pezullohet procedura nga prokurori duhet të njoftohen të gjitha subjektet që janë të përfshira në procedurën për të mitur,

- ka shumë hezitim në shqiptimin e masave të diversitetit që janë risi në ligjin për të mitur.

Regjioni i

Mitrovicës – Një tryezë e ngjashme u organizua me datën 23 nëntor 2007 për gjyqtarët, prokurorët, zyrtarët e shërbimit sprovues dhe pjesëtarë të SHPK-së të regjionit të Mitrovicës, nga e cila dolën këto përfundime:

- puna në dobi të përgjithshme, si masë në këtë regjion nuk shqiptohet fare, andaj duhet të gjinden arsyet dhe shkaqet e mos shqiptimit.
- puna e limituar në punën në dobi të përgjithshme duhet të rregullohet ngase

kjo dispozitë konsiderohet si e mangët për faktin se minimumi është 30 dhe maksimumi 120 orë, e që do të kishte mundësi që kjo masë të jepet edhe në një numër më të vogël, varësisht prej peshës së veprës penale dhe moshës së kryesit.

- qëllimi i masave të diversitetit është mos fillimi i procedurës përgatitore,
- është e domosdoshme krijimi i fondeve të veçanta për zbatimin e këtyre masave,



- në praktikë ka vështirësi në zbatimin e Ligjit për të Mitur, për shkak të mungesës së gjyqtarëve, prokurorëve dhe policëve të specializuar për të mitur si dhe mungesës së

qendrave disiplinore.

Edhe pse evidencat për kryesit e mitur të cilët i ka Qendra për Punë Sociale janë konfidencial ato mund t'iu dorëzohen organeve kompetente të cilat e zhvillojnë procedurën penale me kërkesën e tyre.